

# INTEGRITET LLOGARIDHËNIE PARTNERITET



## **Cikli spiral i bashkëpunimit të “trekëndëshit” – një inovacion për një qasje të qëndrueshme në luftën kundër krimit në nivel vendor**

*Në Shqipëri, shumë aktorë kanë investuar në përgjegjësinë publike të institucioneve që zbatojnë ligjin dhe në reagimin e tyre ndaj prioritetëve të qytetarëve; pak prisnin që çelësi të gjendej në bashkëpunimin trepalësh midis Policisë, Prokurorisë dhe Qeverisë Vendore, “mundësuar” përmes përfshirjes së qytetarëve.*





Institute for Democracy and Mediation  
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

BULETIN Nr. 8  
**Integritet  
Llogaridhënie  
Partneritet**  
Nëntor 2020

### **Stafi i IDM dhe bashkëpunëtorët e projektit:**

**Rovena Sulstarova**, Menaxhere Projekti

**Besjana Kuçi**, Konsulente e Komunikimit

**Anxhela Bruçi**, Asistente Projekti

**Sotiraq Hroni**, Konsulent i Lartë

Për më shumë informacion si dhe për dërgesë të opinionëve mund të na kontaktoni në adresën e email: [info@idmalbania.org](mailto:info@idmalbania.org) ose tel: 042400241

#### **Shënim:**

*Ky buletin u realizua në kuadër të Projektit: “Ndërtimi i Integritetit për përmirësimin e performancës dhe qëndrueshmëria e luftës kundër korrupsionit në Policinë e Shtetit në Shqipëri” i cili mbështetet nga një grant i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta (Holandës). Objektivat, zbatimi i plotë dhe rezultatet e këtij projekti janë përgjegjësi e organizatës zbatuese – Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Çdo qëndrim apo opinion i shprehur në këtë projekt është i organizatës zbatuese dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht ato të qeverisë holandeze.*

CIKLI SPIRAL I BASHKËPUNIMIT TË  
“TREKËNDËSHIT” – NJË INOVACION  
PËR NJË QASJE TË QËNDRUESHME  
NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT NË NIVEL  
VENDOR 4

SI FUNKSIONON CIKLI SPIRAL I  
“TREKËNDËSHIT” NË PRAKTIKË? 5

TAKIM KONSULTUES ME AKTORET E  
“TREKËNDËSHIT” DHE QYTETARËT,  
ELBASAN 7

KALENDARI I AKTIVITETEVE NË  
KUADËR TË PLANIT TË PËRBASHKËT  
SHUMËAKTORIAL PËR PARANDALIMIN  
E KRIMIT NË BASHKINË ELBASAN 8

MBLEDHJA E KËSHILLIT VENDOR PËR  
SIGURINË PUBLIKE ELBASAN 11

TAKIM KONSULTUES ME AKTORET E  
“TREKËNDËSHIT” DHE QYTETARËT,  
LEZHË 12

KALENDARI I AKTIVITETEVE NË  
KUADËR TË PLANIT TË PËRBASHKËT  
SHUMËAKTORIAL PËR PARANDALIMIN  
E KRIMIT NË BASHKINË LEZHË 14

MBLEDHJA E KËSHILLIT VENDOR PËR  
SIGURINË PUBLIKE LEZHË 16

TAKIM KONSULTUES ME AKTORET E  
“TREKËNDËSHIT” DHE QYTETARËT,  
KURBIN 17

PLANI I PËRBASHKËT  
SHUMËAKTORIAL PËR PARANDALIMIN  
E KRIMIT NË BASHKINË KURBIN 18

# KY NUMËR I KUSHTOHET

një inovacioni politikash publike mbështetur në përvojën e takimeve të “trekëndëshit” Bashki-Polici-Prokurori të realizuara nga IDM. Në bashkëpunim me kryetarët e bashkive, drejtorët e drejtorive të policive vendore (shefat e komisariateve) dhe drejtuesit e prokurorive të rretheve gjyqësore në shumë bashki të vendit si Pogradec, Korçë, Librazhd, njësia 5 dhe 7 e bashkisë Tiranë, Elbasan, Berat, Fier, Lushnje, Kavajë, Kamëz, Dropull, Shkodër, Dibër, Lezhë dhe Kurbin.


Mësimet e nxjerra nga përvoja e grumbulluar u konceptuan dhe u pilotuan si qasje ciklike për luftën kundër krimit në Elbasan, Lezhë dhe Kurbin. Pikërisht këto takime dhe planet shumëaktoriale vendore respektive përshkruhen në këtë buletin.

Cikli nis me takimet konsultuese të “trekëndëshit” që përbëjnë një përpjekje të drejtpërdrejtë për të përfshirë qytetarët në operacionalizimin e infrastrukturës së sigurisë në nivel lokal. Ato rrisin përgjegjshmërinë e secilit prej institucioneve të “trekëndëshit” dhe njëherazi nxisin kohezionin midis detyrimeve të bashkisë për shërbime sa më cilësore; me ndarjen e pronësisë me aktorët e tjerë nga ana e Policisë së Shtetit për planin e veprimit për policimin në komunitet, si dhe me punën e prokurorisë për edukimin dhe informimin ligjor të komunitetit, në mënyrë të veçantë të rinjve.

Pas takimeve konsultuese, institucionet e “trekëndëshit” ndërvepruan midis tyre dhe me IDM-në për të evidentuar problematikat dhe kërcënimet vendore të sigurisë. Mbi bazën e tyre u hartua plani shumëaktorial për luftën kundër krimit në nivel vendor i cili u bë pjesë e diskutimit dhe miratimit në mbledhjen e rradhës të Këshillit Vendor për Sigurinë Publike. Në këtë buletin, botohen pjesë nga prioritete të ndryshme të secilit prej këtyre planeve shumëaktoriale të bashkive në fokus. Miratimi i planit shumëaktorial nga Këshilli Vendor të Sigurisë Publike (KVSP) e shndërron këtë institucion në një “qendër të vlerësimit të prioriteteve të sigurisë vendore”.

Megjithëse mund të thuhet se praktika frymëzohet nga ajo që në Holandë njihet si “trekëndëshi i artë”, përvoja e aplikuar nga IDM është tërësisht e mbështetur në legjislationin dhe praktikat vendase. Eksperiencia e deritanishme, nuk ka krijuar asnjë sforcim dhe gjithçka është realizuar nga vetë institucionet.

Plani shumëaktorial vendor ka karakter gjithëpërfshirës dhe kërkon kontributin e institucioneve publike, private, shoqërisë civile, qytetarëve për zbatimin e tij. Në këtë buletin, përshkruhet edhe roli që kanë titullarët e institucioneve dhe sekretariati teknik pranë çdo institucioni të “trekëndëshit”.



# CIKLI SPIRAL I BASHKËPUNIMIT TË “TREKËNDËSHIT” – NJË INOVACION PËR NJË QASJE TË QËNDRUESHME NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT NË NIVEL VENDOR

*Në Shqipëri, shumë aktorë kanë investuar në përgjegjësinë publike të institucioneve që zbatojnë ligjin dhe në reagimin e tyre ndaj prioriteteve të qytetarëve; pak prisnin që çelësi të gjendej në bashkëpunimin trepalësh midis Policisë, Prokurorisë dhe Qeverisë Vendore, “mundësuar” përmes përfshirjes së qytetarëve.*

Krimi është arsyeja kryesore pse shumica e shqiptarëve ndihen të pasigurt në përditshmërinë e tyre.<sup>1</sup> Për këtë arsye, parandalimi dhe lufta kundër krimit janë të një rëndësie të madhe, jo vetëm për agjencitë e zbatimit të ligjit, por edhe për qeveritë vendore të cilat janë përgjegjëse për cilësinë e jetës së qytetarëve. Mbi këtë bazë, IDM nisi të avokonte vite më parë për përgjegjësinë e përbashkët dhe për një bashkëpunim më të ngushtë midis institucioneve dhe aktorëve kyç në kontekstin e sigurisë publike. Ndërsa iniciativa të shumta kanë bërë përpjekje për të përmbushur këtë objektiv, çelësi i rezultateve të qëndrueshme u gjet në të ashtuquajturin bashkëpunim të “trekëndëshit” midis policisë, prokurorisë dhe bashkisë, një mekanizëm i cili lehtësohet dhe plotësohet nga përfshirja e qytetarëve.


Gjatë vitit 2018-2019, IDM pilotoi me sukses takime publike konsultuese për parandalimin e krimit dhe sigurinë publike

në nivel vendor. Drejtuesit e institucioneve të “trekëndëshit” (Bashkia, Policia dhe Prokuroria) u takuan me qytetarë, përfaqësues të institucioneve arsimore, të rinj, prindër, grupe të ndryshme interesi, përfaqësues të shoqërisë civile, komunitetin e biznesit, anëtarë të Këshillave Bashkiakë, media dhe aktorë të tjerë të interesuar për të diskutuar mbi sfidat vendore dhe prioritetet për parandalimin e krimit.

Një nga pengesat në luftën dhe parandalimin e krimit ka qenë mungesa e përfshirjes së qytetarëve dhe grupeve të interesit në iniciativa lokale për të përmirësuar sigurinë publike dhe për ta bërë ate një proces përfshirës dhe të drejtuar nga iniciativat vendore. Një studim i IDM arriti në përfundimin se strategjitë e Policimit janë hartuar pa përfshirjen e ndonjë institucioni tjetër vendor ose pjesëmarrjen e qytetarëve. Pilotimi i takimeve të “trekëndëshit” nga IDM në tre bashki të vendit, Elbasan, Lezhë dhe Kurbin adreson mungesën e përfshirjes së qëndrueshme të komunitetit dhe prezanton qytetaret si një aktor shumë të rëndësishëm në ndërtimin e një axhende të mirëfilltë për sigurinë vendore. Kjo jo vetëm e bën procesin shumëaktorial dhe gjithëpërfshirës, por nga ana tjetër siguron përgjegjshmërinë e institucioneve ndaj qytetarëve.

••••

1 Ky trend vazhdon që nga 2016. Sipas sondazhit vjetor të IDM “Besimi në Qeverisje”, 71% e shqiptarëve në 2018 dhe 67% në 2019 kanë raportuar që krimi është arsyeja kryesore për tu ndjerë të pasigurt. Shikoni “Besimi në Qeverisje 2019” faqe 117. Burimi: [https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/democrat\\_governance/-trust-in-governance--opinion-poll-2019-.html](https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/democrat_governance/-trust-in-governance--opinion-poll-2019-.html) Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Buletini nr.5 “Integritet, llogaridhënie, partneritet”, 2020



## SI FUNKSIONON CIKLI SPIRAL I “TREKËNDËSHIT” NË PRAKTIKË?

Diagrama e mëposhtme paraqet grafikisht procesin ciklik spiral të “trekëndëshit”. Aktiviteti fillon me takimet konsultuese të “trekëndëshit” (me pjesëmarrjen e Kryetarit të Bashkisë, drejtuesit e Prokurorisë së Rrethit dhe drejtuesit e Policisë), me qytetarë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe grupe interesi

të cilët sjellin në tryezë problemet dhe kërcënimet e sigurisë në komunitet. Takimet konsultuese të “trekëndëshit” provuan të jenë një dimension i munguar në punën e institucioneve ligjzbatuese. Ato rezultuan një instrument i suksesshëm për përfshirjen e qytetarëve në avancimin e një axhende të sigurisë nga poshtë-



lart përmes hartezimit të rreziqeve dhe kërcënimeve ndaj sigurisë publike.

Më pas, IDM në bashkëpunim me zyrën e kryetarit të bashkisë dhe partnerë të tjerë të “trekëndëshit” përkthyer rreziqet e identifikuar për sigurinë në një plan tre vjeçar për parandalimin e krimit i cili i përcillet Këshillit Vendor për Sigurinë Publike (KVSP) për vendimmarrjen e përbashkët të anëtarëve.

**Procesi i zbatimit të planit shumëaktorial mund të konsiderohet më të drejtë**

**procesi më sfidues.** Plani kërkon nga “trekëndëshi”, si dhe institucione të tjera publike dhe private për të punuar vazhdimisht me njëri-tjetrin për zbatimin e masave të ndryshme të identifikuar. Trekëndëshat e vegjël në diagram paraqesin mundësinë e mbajtjes së takimeve të ndryshme konsultuese midis institucioneve të “trekëndëshit” sipas nevojave të ndryshme që dalin nga procesi i zbatimit të planit. Këto takime, sipas rastit, zhvillohen ose në nivelin e drejtuesve të institucioneve të “trekëndëshit” ose të Sekretariatit Teknik të tij.

Çdo gjashtë muaj, drejtuesit e institucioneve të “trekëndëshit” organizojnë takimin e radhës konsultues për të vlerësuar së bashku me qytetarët nivelin e zbatimit të planit. Në të njëjtën kohë, këto takime shërbejnë për përditësimin e planit me informacion dhe objektiva të reja.

Përshkrimi i ciklit garanton funksionimin e vazhdueshëm të bashkëpunimit të institucioneve të “trekëndëshit”, në një mënyrë të vazhdueshme spirale. Kështu, “trekëndëshi” siguron mjedisin për hartimin, zbatimin dhe përditësimin e politikave dhe masave për sigurinë të drejtuara nga qytetarët. Kjo qasje është inovative për mënyrën se si nxit ndërveprimin dhe bashkëpunimin ndërmjet institucioneve, nga ana tjetër, zhvillimi ciklik i takimeve të “trekëndëshit” siguron që politikat vendore të sigurisë

të kenë në qendër qytetarët. Në të njëjtën kohë, procesi përfshin dhe fuqizon qytetarët në kërkim të përgjegjësive institucionale dhe për një qeverisje me pjesëmarrje.

Ky proces bashkëpunimi ndërinstitucional vendor nga njëra anë kërkon ndarjen e përgjegjësive dhe bashkëpunimin midis institucioneve, ndërsa nga ana tjetër ndikon në përmirësimin e performancës publike për secilin institucion të “trekëndëshit.

**Për Policinë,** kjo do të thotë që për herë të parë parandalimi dhe lufta kundër krimit nuk është ekskluzivisht përgjegjësia e saj, por ndahet gjerësisht në nivel lokal me shumë aktorë vendor duke përfshirë dhe qytetarët.

**Për Prokurorinë,** kjo do të thotë që për herë të parë institucioni të dalë nga zyra drejt qytetarit, duke u investuar për sensibilizimin e komuniteteve mbi statistikën dhe trendët e kriminalitetit dhe në mënyrë të veçantë në edukimin ligjor të të rinjve.

**Për Bashkinë,** kjo do të thotë të marrësh më shumë përgjegjësi për cilësinë e jetës së qytetarëve përmes mbështetjes dhe shërbimeve më të mira për sigurinë publike. Praktika rezultojnë në përgjegjësi dhe kompetenca gjithnjë në rritje për qeverisjen vendore në Shqipëri.



## TAKIM KONSULTUES ME AKTORET E "TREKËNDËSHIT" DHE QYTETARËT, ELBASAN

Në fjalën hapëse të takimit konsultues në teatrin Skampa të Elbasanit me përfaqësues të shoqërisë civile dhe grupe të interesit, Kryetari i Bashkisë Elbasan, z. Llatja, theksoi se pjesëmarrja e aktoreve të ndryshëm në takim tregon mbështetje maksimale për sigurinë publike dhe parandalimin e krimit. Ai shtoi se Bashkia Elbasan po përpiqet ta bëjë të përhershme praktikën e "trekëndëshit" në bashkëpunim me Policinë dhe Prokurorinë. Në vijim, solli në vëmendje të pranishmeve, se qëllimi i takimeve të tilla është që drejtuesit e "trekëndëshit" të identifikojnë problematikat që ndeshin qytetarët në përditshmërinë e tyre. Kryetari shpjegoi se mbi bazën e problemeve të identifikuar do të shkohet drejt një plani për tu miratuar në Këshillin Vendor të Sigurisë Publike (KVSP). Ai shtoi se Bashkia ka në plan që së shpejti të ngrëjë strukturat komunitare në qytet si një organizim në nivel lagjeje që do të mundësojë një shtysë domethënëse bashkëpunimit midis bashkisë, komunitetit, Policisë së Shtetit dhe institucioneve të tjera ligjzbatuese.

**Kreshnik Ajazi**, Drejtues i Prokurorisë së Rrethit theksoi se drejtësia duhet kuptuar si një shërbim publik, prandaj është e nevojshme që të gjithë aktorët të jenë të bashkuar. Prokurori shtoi se institucioni që ai përfaqëson është përpjekur të jetë i hapur dhe transparent ndaj qytetarëve për aq sa e lejon ligji. Ai cilësoi se kanë ashpërsuar politikën penale për shpërndarjen e lëndëve narkotike dhe për rastet e dhunës në familje në funksion të parandalimit të tyre, duke shtuar se bashkëpunimi midis Policisë dhe Prokurorisë ka qenë organik dhe funksional.

**Arjan Muça**, Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan gjatë fjalës së tij vuri theksin në rëndësinë që ka bashkëpunimi



i aktorëve të "trekëndëshit" në interes të zgjidhjes së problematikave të qytetarëve, si dhe të rritjes së efikasitetit të luftës kundër krimit të organizuar dhe krimit në përgjithësi. Gjithashtu, ai u ndal në rëndësinë që ka bashkëpunimi dhe rritja e besimit të qytetarëve të policia. Ai shtoi se Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan e ka ndërtuar punën e saj në bashkëpunimin gjithëpërfshirës dhe në përgjegjshmërinë institucionale në shërbim të axhendës vendore të sigurisë. Drejtori theksoi se një nga prioritetet e tyre janë lufta kundër krimit, rritja e parametrevë të sigurisë rrugore, rritja e parametrevë të rendit dhe sigurisë në tërësi, heqja e qarkut të Elbasanit nga harta e kultivimit të Kanabis Sativa, dhe forcimi i bashkëpunimit me gjithë institucionet vendore dhe komunitetin.

Drejtoresha e Zyrës Vendore të Arsimit në Elbasan, Anila Çota u shpreh se është shumë e rëndësishme të garantohet siguria në institucionet arsimore dhe bashkëpunimi midis prindërve, fëmijëve, mësuesve. Ajo shtoi se parandalimi i përdorimit të drogave ka rezultuar i suksesshëm, me përjashtim të disa rasteve sporadike. Drejtoresha ngriti



disa problematika lidhur me çështjet administrative në shkollë duke shtuar se mungon personeli i trajnuar, kamerat dhe pajisjet që sigurojnë mbrojtjen në rast zjarri.

Përfaqësues të shoqërisë civile sollën në vëmendje të pjesëmarrësve disa problematika lidhur me sigurinë publike. U propozua ngritja e strukturave me mediator social për të lehtësuar punën

e Policisë në çështje pa karakter penal. Kryetari i Qendrës së Bashkëpunimit Ndërfetar në Elbasan z. Arben Ramkaj, u shpreh se në Elbasan ekziston kodi i heshtjes duke theksuar se është e nevojshme të krijohen takime periodike midis institucioneve dhe qytetareve, dhe të ketë bashkëpunim të vazhdueshëm midis tyre.

## KALENDARI I AKTIVITETEVE NË KUADËR TË PLANIT TË PËRBASHKËT SHUMËAKTORIAL PËR PARANDALIMIN E KRIMIT NË BASHKINË ELBASAN

Gjatë mbledhjes së Këshillit Vendor për Sigurinë Publike (KVSP) u diskutua dhe votua nga të gjithë anëtarët plani shumëaktorial në luftën kundër krimit. Anëtarët e KVSP shprehen besimin e tyre të plotë në zbatimin e këtij plani.

Objektivat e këtij plani janë:

1. Ngritja e kapaciteteve dhe investimi shumëaktorial i cili përfshin qytetarët në parandalimin e krimit

2. Reduktimi i intensitetit dhe eliminimi gradual i dukurive që kërcënojnë sigurinë publike dhe në veçanti grupet vulnerabël
3. Investimi në një qasje të vazhdueshme, të përsëritur çdo 6-muaj dhe gjithëpërfshirëse të “trekëndëshit” me publikun

Mëposhtë janë paraqitur disa nga prioritetet që përmban plani shumëaktorial për parandalimin e krimit në Elbasan

PROBLEMATIKA DHE PRIORITETI	TITULLI I AKTIVITETIT	INSTITUCIONI PERGJEGJES	KOHA
<b>Përgatitja dhe ngritja e kapaciteteve të “trekëndëshit” në kuadër të këtij plani (prioritet i moderuar)</b>	Bashkia miraton buxhetin në zbatimin e neneve 68,69 për ligjin e qeverisjes vendore për ngritjen e strukturave komunitare në qytetin e Elbasanit (parashikohen rreth 24 struktura komunitare/ndërlidhës për gjithë territorin e qytetit të Elbasanit)	Bashkia Elbasan Këshilli Bashkiak Elbasan	NËNTOR & DHJETOR 2020
	Ngritja e strukturave komunitare dhe trajnimi i tyre për të ngritur kapacitetet për partneritete me institucionet	Bashkia Elbasan IDM OJF	6-MUJORI I PARË 2021



PROBLEMATIKA DHE PRIORITETI	TITULLI I AKTIVITETIT	INSTITUCIONI PERGJEGJES	KOHA
	Drejtuesit e institucioneve të "trekëndëshit" bëjnë të ditur për stafin e çdo institucioni për detyrimet ndaj këtij plani	Komisariati i Policisë Elbasan Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Bashkia Elbasan	DHJETOR 2020
	Ngritja e strukturës teknike në përbërjen e së cilës janë përfaqësues të Policisë, Prokurorisë Dhe Bashkisë. Kjo strukturë funksionon si sekretariat teknik i "trekëndëshit" pranë Bashkisë	Komisariati i Policisë Elbasan Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Bashkia Elbasan	NËNTOR 2020
<b>Përballja me dukurinë e "kulturës së heshtjes" nga institucionet e "trekëndëshit" (prioritet i moderuar)</b>	Rritja e komunikimit dhe transparencës të institucioneve të "Trekëndëshit" me qytetarët	Komisariati i Policisë Elbasan Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Bashkia Elbasan	DHJETOR 2020 - në vazhdim - komunikim periodik/ minimalisht një herë në muaj (institucionet e "trekëndëshit" mund të bëjnë publik këtë plan/ ose ecurinë e këtij plani)
	Mbajtja e takimeve periodike me OJF dhe grupe të tjera të interesit nga institucionet e "trekëndëshit" për tu njohur me problematikat e tyre	Komisariati i Policisë Elbasan Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Bashkia Elbasan	ÇDO TRE MUAJ
	Rritja e komunikimit dhe partneritetit të Policisë me qytetarët (përmes strukturave komunitare)	Komisariati i Policisë Elbasan OJF	6-MUJORI I DYTË 2021



PROBLEMATIKA DHE PRIORITETI	TITULLI I AKTIVITETIT	INSTITUCIONI PERGJEGJES	KOHA
<b>Lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm (prioritet i ulët)</b>	Institucionet e “trekëndëshit” bashkëpunojnë me qendrën e bashkëpunimit Ndërfetar dhe shoqërinë civile për organizimin e takimeve sensibilizuese dhe ndërgjegjësuese të komunitetit sipas problematikave	Komisariati i Policisë Elbasan Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Bashkia Elbasan Drejtoria Arsimore Qendra e bashkëpunimit Ndërfetar OJF	NË VAZHDIMËSI
<b>Zonat e “nxehta” / hotspotet për përdoruesit dhe shpërndarësit e drogës apo të krimit (prioritet i lartë)</b>	Identifikimi i zonave të “nxehta” për përdoruesit dhe shpërndarësit e drogës dhe bërja e tyre publike	Komisariati i Policisë Elbasan Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Bashkia Elbasan	DHJETOR 2020
	Përmirësimi i një sistemi vëzhgues të kamerave në qytet në mënyrë të veçantë në zonat e “nxehta” / hotspote	Komisariati i Policisë Elbasan Bashkia Elbasan	3-MUJORI I PARË 2021
	Puna operative në forma të ndryshme të Policisë për të goditur këto grupe keqbërëse	Komisariati i Policisë Elbasan (Sektori i krimeve)	NË VAZHDIMËSI
	Evidentimi individual i frekuentuesve të zonave të “nxehta” dhe bashkëpunimi shumëaktorial për të ulur intensitetin e përfshirjes individuale në grupe	Komisariati i Policisë Elbasan Bashkia Elbasan Qendra e bashkëpunimit Ndërfetar OJF Institucionet Arsimore	NË VAZHDIMËSI
	Ndjekja në vazhdimësi të dinamikës së lëvizjes dhe ndryshimit të zonave të “nxehta”	Komisariati i Policisë Elbasan (Sektori i krimeve)	NË VAZHDIMËSI

## MBLEDHJA E KËSHILLIT VENDOR PËR SIGURINË PUBLIKE ELBASAN

Në hapjen e mbledhjes së Këshillit Vendor për Sigurinë Publike në Elbasan, Kryetari i Bashkisë Elbasan, Gledjan Llatja, e quajti prezantimin e planit shumëaktorial për parandalimin e krimit si një dëshmi të maturimit të punës së KVSP të nisur që në vitin 2016 në këtë bashki. Ai shtoi se ky plan, i cili është hartuar me ekspertizën e Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim, vjen si rezultat i një bashkëpunimi të mirë midis institucioneve dhe qytetarëve.

Z. Llatja theksoi se me anë të këtij plani arrihet:

Së pari, institucionalizimi i “trekëndëshit” (Bashki, Polici, Prokurori).

Së dyti, Këshilli Vendor për Sigurinë Publike (KVSP) merr një formë më operacionale pune, me një axhendë konkrete.

Pasi shpjegoi planin dhe përgjegjësitë përkatëse për çdo aktor, kryetari i bashkisë përmendi tre pika të nxehta (hotspote) të krimit, si ajo e stacionit të trenit, një pjesë e parkut rinia, dhe në disa lagje periferike të qytetit.

Të gjithë këto hotspote janë pjesë e planit të përbashkët për të cilat policia do të raportojë në takimin e radhës publik të “trekëndëshit”

“Plani i përbashkët shumëaktorial për parandalimin e krimit në Bashkinë Elbasan është planifikuar mirë. Në këtë plan veprimi janë përcaktuar qartë prioritetet duke i shkallëzuar në prioritet të lartë, të moderuar, dhe të ulët”. **Drejtori i Policisë Vendore Elbasan, Alket Shatro.**



Z. Shatro identifikoi si fenomen shqetësues krimet ndaj pronës dhe kryesisht vjedhjet e banesave dhe bizneseve. Duke theksuar se fokusi kryesor ka qenë siguria në shkollë, ai përmendi problematika të lidhura me shmangien e ngjarjeve kriminale si dhe shitjen e lëndëve narkotike në shkollë dhe në afërsi të tyre. U shfaq i preokupuar për parandalimin e krimit dhe evidentoi disa zona ku ka sinjalizime për përdorimin dhe shpërndarjen e lëndëve narkotike. Z. Shatro përmendi se janë zhvilluar tema kundër përdorimit të duhanit dhe drogës në të gjithë shkollat në Elbasan. Ai shtoi se me kërkesë të Gjimnazit “Vasil Kamami” Elbasan është zhvilluar tema “Trafikimi i qenieve njerëzore”.

Një shqetësim tjetër i identifikuar lidhet me konfliktet për pronën të cilat gjenerojnë vepra penale kundër personit. Gjithashtu, ai përmendi problematikën e dhunës në familje duke theksuar se ka një trend në rritje të denoncimeve të rasteve të dhunës në familje. Ai shtoi se një nga prioritet kryesorë mbetet parandalimi, goditja dhe zhdukja e kultivimit të bimëve narkotike.

Drejtues i Prokurorisë, **Kreshnik Ajazi**, e quajti planin shumëaktorial për parandalimin e krimit si një mekanizëm konkret që do të ndikojë në sigurinë publike. Ai theksoi se Prokuroria merr përsipër të gjithë detyrimet nga ky plan, duke i dedikuar një bashkëpunim të veçantë me përfaqësues të prokurorisë në bashkëpunim me shkollat dhe OJF-të, për edukimin ligjor dhe sensibilizimin për trendët e kriminalitetit në Elbasan. Z. Ajazi u shpreh optimist për zbatimin dhe konkretizimin e një plani për parandalimin e krimit. Ai theksoi se prokuroria është e angazhuar në rritjen e bashkëpunimit me qytetaret. Për më tepër ai shtoi se institucioni që ai drejton ka bërë dy marrëveshje me OJF në Elbasan lidhur me eliminimin e dhunës me bazë gjinore. Prokurori kërkoi që të përfshihet në plan realizimi i dyerve të hapura nga Prokuroria për nxënësit e shkollave të mesme të Elbasanit.

Drejtoresha e Zyrës Vendore të Arsimit në Elbasan, **Anila Çota**, vlerësoi planin dhe shprehu besimin në realizimin e tij, ajo theksoi se nga konsultimi i zhvilluar nga drejtuesit e “trekëndëshit” me qytetarët e Elbasanit, kalohet në një plan pune konkret dhe operacional. Ajo shtoi se

drejtoria arsimore duhet të përfshihet në më shumë pika të planit dhe të ketë rol aktiv si në parandalimin e përdorimit të lëndëve narkotike dhe alkoolit apo dhe në parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore, përmes fushatave sensibilizuese dhe identifikimit të hershëm të rasteve potenciale për trafikim.

Kapacitetet e institucioneve të “trekëndëshit” luajnë një rol kryesor në hartimin dhe zbatimin e planit shumëaktorial. Ndërveprimi në kuadër të “trekëndëshit” nuk është çështje vetëm e titullarëve dhe as e sekretariatit teknik të “trekëndëshit”, por një filozofi pune që duhet të kihet parasysh nga institucionet në tërësi. Një punë e bashkërenduar shumëaktoriale e nisur nga Policia e Shtetit për eliminimin e pikave të nxehta (hotspoteve) të krimit në qytet, e shndërron policimin në shkencë. Analiza e pikave të nxehta (hotspoteve) orienton ndërhyrjen e cila mund të kërkojë veprim policor apo veprim të bashkërenduar me atë social. Me veprim social kuptohet edhe përfshirja e bashkisë, shkollës, familjes apo komunitetit vendor. **Drejtori i IDM-së, Sotiraq Hroni**

## TAKIM KONSULTUES ME AKTORET E “TREKËNDËSHIT” DHE QYTETARËT, LEZHË

Bashkëpunimi në kuadër të institucioneve të “trekëndëshit” për parandalimin e krimit është shumë i rëndësishëm në mënyrë që lufta kundër krimit të mos mbetet vetëm detyrim i Policisë së Shtetit. Bashkia Lezhë dhe të gjithë institucionet e tjera do të japin kontributin e tyre në zbatimin e ligjit. Për të parandaluar krimin duhet bërë evidentimi i problematikave që nga qeliza e familjes, shkolla, kryeploqët, administratorët, dhe shërbimi social.

Kriminaliteti është një fenomen social i cili kërkon gjithnjë e më shumë bashkëpunim shumëaktorial, duke përfshirë Bashkinë, Policinë, Prokurorinë dhe institucione të tjera vendore. - **Pjerin Ndreu, Kryetar i Bashkisë Lezhë**

Duhet rritur bashkëpunimi i njëjësive vendore me Policinë për rastet e evidentuara për kultivimin e Kanabis. Njëherazi, konfliktet mbi pronën janë një çështje që duhet të jetë në vëmendje

të Kadastrës, një institucion i cili duhet të zbatojë ligjin 20/2020 për çështjet e pronësisë të cilat sjellin problematika dhe konflikte për qytetarët. Shprehim gatishmërinë që prokuroria Lezhë të investohet në edukimin ligjor të nxënësve, duke shtuar masat për parandalimin e përdorimit të bimëve narkotike dhe për sensibilizimin ndaj fenomenit të bullizmit, një fenomen problematik në shkolla - **Milan Laskaj, Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Lezhë**




**Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, Zef Laska** tha se komuniteti përballet me disa problematika për të cilat nevojitet bashkëpunim pasi policia nuk mundet t'i japë e vetme zgjidhje problematikave. Më tej z. Laska u shpreh se përballet me problematika të ndryshme të sigurisë publike, deri te konfliktet për pronën dhe ujin. Ai vlerësoi bashkëpunimin e institucioneve dhe ftoi pjesëmarrësit të adresojnë problematikat në takim. Z. Laska e cilësoi jetike rritjen e bashkëpunimit me qytetarët, komunitetin, dhe institucionet për sigurinë publike.

**Drejtoresha e ZVAP Lezhë, Antoneta Suta** shprehu nevojën për pajisje me kamera për të gjithë shkollat, duke kërkuar në mënyrë të veçantë mbulimin me kamera të mjediseve përreth shkollave. Ndërsa për shkollat me numër të lartë nxënësish duhet të ketë prani të forcave të Policisë në oraret e ardhjes dhe largimit të nxënësve. Ajo shpjegoi se shtimi i orëve edukative me Policinë dhe prokurorinë do të bënte tematikat e trajtuara më të kuptueshme për nxënësit. Për më tepër, u theksua se media duhet të ketë një rol më të shtuar në mbulimin e problematikave që prekin të rinjtë.

**Shef i Sektorit të Policimit në Komunitet nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Ferdinand Zera** përshëndeti takimet konsultuese në Elbasan dhe Lezhë duke venë në dukje se takimet e “trekëndëshit”

janë një mundësi për të sjellë bashkë të gjithë aktorët publikë, privat, anëtarët e Këshillit Bashkiak, aktorë të komuniteteve fetare, përfaqësues të biznesit, prindër, nxënës, dhe të gjithë aktorët e shoqërisë civile për të diskutuar mbi çështjet e krimit. Këto takime me qytetarët që moderohen nga drejtuesit e “trekëndëshit” trajtojnë problematika jetësore për komunitetet. Më tej, ai kërkoi që të rritet bashkëpunimi me kryepleqtë dhe këshillin e fshatit, duke ndihmuar në marrjen e masave nga institucionet për zgjidhjen e problematikave të ndryshme. Ai vlerësoi rolin parandalues të prokurorisë duke bërë referimin dhe regjistrimin e procedimeve proaktive përmes të cilave mund të parandalohet krimi.

- ▣ Përfaqësues të shoqërisë civile në Lezhë theksuan se është e domosdoshme përfshirja e shoqërisë civile në takimet konsultuese të “trekëndëshit” dhe kërkuar për rritjen e besimit të qytetarëve me Policinë. Ata sensibilizuan për shmangjen e eksperiencave ku qytetarët nuk ndihen të sigurtë në komunikimin me Policinë.
- ▣ Drejtor i Shkollës “Gjovalin Gjadri” dhe anëtar i Këshillit Bashkiak Lezhë shtoi për nevojën e mbrojtjes së sinjalizuesve. Ai theksoi se nëse aktorët e “trekëndëshit” do të jenë





bashkëpunues, krimi do të ulë forcën e vetë dhe do të dobësohet para ligjit.

- ▣ Administratori në Njësinë Bashkiake Zejmen ngriti shqetësimin e sigurisë rrugore për aksidentet me pasoja të rënda për këmbësorët dhe vetë drejtuesit e mjeteve. Ai kërkoi vendosjen e kamerave në shkolla dhe në akse

rrugore që përbëjnë rrezikshmëri të lartë.

Në takimin e Lezhës të rinj të ndryshëm patën një rol aktiv në diskutim duke kërkuar nga institucionet e “trekëndëshit” dhe në veçanti nga Drejtori i Policisë shtimin e patrullimit të zonave përreth shkollës, sidomos për shkollat me katër turne.

## KALENDARI I AKTIVITETEVE NË KUADËR TË PLANIT TË PËRBASHKËT SHUMËAKTORIAL PËR PARANDALIMIN E KRIMIT NË BASHKINË LEZHË

PROBLEMATIKA DHE PRIORITETI	TITULLI I AKTIVITETIT	INSTITUCIONI PERGJEGJES	KOHA
<b>Siguria në shkollë (prioritet i moderuar)</b>	Vlerësimi i efektivitetit të sistemit aktual të kamerave të sigurisë dhe i mundësisë për bashkë menaxhim të sistemit të kamerave midis bashkisë dhe Policinë	Ekspert përkatës të Policisë dhe bashkisë brenda muajt Dhjetor bëjnë një raport vlerësues për të ja dërguar titullarëve	DHJETOR 2020
	Krijimi i një sistemi të integruar të monitorimit të kamerave për qytetin e Lezhës	Komisariati i Policisë Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Bashkia Lezhë	6-MUJORI I PARË 2021
	Dërgimi i një raporti një-mujor lidhur me problematikat në çdo shkollë	Komisariati i Policisë Drejtoria Arsimore	PERIODIKE/ ÇDO MUAJ
	Avokim për vendosjen e një oficeri policie për shkolla me numër të lartë nxënësish	Komisariati i Policisë Bashkia Lezhë Drejtoria Arsimore	6-MUJORI I PARË 2021






PROBLEMATIKA DHE PRIORITETI	TITULLI I AKTIVITETIT	INSTITUCIONI PERGJEGJES	KOHA
<b>Konfliktet e lidhur me pronën dhe ujin (prioritet i lartë)</b>	Rritja e bashkëpunimit midis institucioneve të “trekëndëshit” dhe institucioneve përgjegjëse për zgjidhjen e problemeve të identifikuara	Bashkia Lezhë Prokuroria e Rrethit Gjqësor Komisariati i Policisë Lezhë Agjencia Shtetërore e Kadastrës	NË VAZHDIMËSI
	Zbatimi i ligjit 20/ 2020 për çështjet e pronësisë	Bashkia Lezhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës	NË VAZHDIMËSI
	Nxitja e partneritetit midis Policisë dhe strukturave komunitare/ ndërlidhësit komunitar (Këshilli i fshatit, Kryetari i fshatit)	Komisariati i Policisë (Sektori i policimit në komunitet) Bashkia Lezhë OJF (World Vision & Kryqi i kuq)	6-MUJORI I PARË 2021
<b>Fenomeni i bullizmit në shkollë (prioritet i moderuar)</b>	Takime sensibilizuese dhe ndërgjegjësuese nga institucionet e “trekëndëshit” në shkolla	Komisariati i Policisë Lezhë Prokuroria e Rrethit Gjqësor Bashkia Lezhe OJF (World Vision & Kryqi i kuq)	6-MUJORI I PARË 2021
	Bashkëpunim midis shkollës dhe OJF-ve që operojnë në Lezhë për të mundësuar aktivitete psiko sociale për të rinjtë	Komisariati i Policisë Lezhë Prokuroria e Rrethit Gjqësor OJF (World Vision & Kryqi i kuq)	NË VAZHDIMËSI
	Forcimi i rolit të psikologut në shkolla për të lehtësuar barrierat në komunikim midis nxënësve dhe shkollës	Drejtoria Arsimore	NË VAZHDIMËSI



PROBLEMATIKA DHE PRIORITETI	TITULLI I AKTIVITETIT	INSTITUCIONI PERGJEGJES	KOHA
<b>Siguria rrugore në Lezhë (prioritet i lartë)</b>	Evidentimi i zonave me rrezikshmëri të lartë për sigurinë rrugore dhe bashkëpunimi shumëaktorial për të ulur rrezikshmërinë	Komisariati i Policisë Lezhë Bashkia Lezhë	DHJETOR 2020
	Përmirësimi i një sistemi vëzhgues të kamerave në qytet në mënyrë të veçantë në zonat që kanë rrezikshmëri të lartë për sigurinë rrugore	Komisariati i Policisë Lezhë Bashkia Lezhë	3-MUJORI I PARË 2021
	Vendosja e shenjave të qarkullimit horizontal dhe “policave të shtrirë” në zonat me rrezikshmëri të lartë për sigurinë rrugore	Komisariati i Policisë Lezhë Bashkia Lezhë	3-MUJORI I PARË 2021

## MBLEDHJA E KËSHILLIT VENDOR PËR SIGURINË PUBLIKE LEZHË

Në datën 18 nëntor 2020 u zhvillua online mbledhja e Këshillit Vendor për Sigurinë Publike në Bashkinë Lezhë me pjesëmarrjen e anëtarëve të Këshillit Bashkiak Lezhë, Drejtorisë vendore të Policisë, dhe Prokurorisë së Rrethit. Gjatë këtij takimi, u prezantua dhe dakordësua mbi objektivat e cilësuara si prioritare nga qytetarët e Lezhës. Drejtuesit e institucioneve të “trekëndëshit” shprehen gatishmërinë për zbatimin e planit. Takimi u përshëndet edhe nga Prefekti i Lezhës, z. Gjokë Jaku, i cili sugjeroi që plani të përfshijë dhe një mirë-organizim të detyrave dhe përgjegjësisë të Policisë Bashkiake, me qëllim që kjo e fundit t’i vijë në ndihmë Policisë së Shtetit.



## TAKIM KONSULTUES ME AKTORET E "TREKËNDËSHIT" DHE QYTETARËT, KURBIN

Në Kurbin pati shumë pjesëmarrje nga të rinj dhe nxënës të shkollave në Mamurras, Laç dhe Kurbin, kryetar fshatrash, drejtues shkollash dhe OJF. Problematika mjaft delikate të ngritura prej tyre u përfshinë në planin shumëaktorial për parandalimin e krimit për Bashkinë Kurbin.

**Kryetarja e Bashkisë Kurbin, Majlinda Cara,** theksoi se takimet me publikun mundësojnë një pamje më të plotë të situatës në qytet dhe mundësojnë politika dhe nisma që i përgjigjen më mirë nevojave të qytetarëve. Kryetarja shtoi se secili nga institucionet e "trekëndëshit" duhet të angazhohet për të mbajtur bashkëpunimin shumëaktorial dhe për t'u angazhuar në zgjidhjen e problematikave të qytetarëve. Ajo u shpreh e gatshme për mbajtjen e takimeve periodike me institucionet dhe grupet e interesit dhe i bëri thirrje strukturave vendore të jenë pjesë aktive e ngritjes së problematikave nga qytetarët.

**Drejtues i Policisë Lezhë z. Zef Laska,** dhe Drejtuesi i prokurorisë z. Arben Nika mbështetën kryetaren në këtë qasje dhe bënë thirrje për më shumë bashkëpunim duke theksuar se siguria publike është një çështje që i takon gjithsecilit prej institucioneve të "trekëndëshit" dhe për këtë arsye është e nevojshme që të gjithë aktorët të jenë të bashkuar.



Grupe të rinjsh të shkollave të mesme në Kurbin, Laç dhe Mamurras, pjesëmarrës në takimin konsultues, ngritën shumë shqetësime në lidhje me problematikën e sigurisë në shkolla, përdorimit të drogës, dhe sigurisë rrugore.

Nga drejtuesit e shkollave u kërkua zgjerimi i numrit të shkollave si qendër komunitare.

Nga shumica e të rinjve të pranishëm në takim u kërkua më shumë punë për të ndryshuar imazhin e qytetit.

## PLANI I PËRBASHKËT SHUMËAKTORIAL PËR PARANDALIMIN E KRIMIT NË BASHKINË KURBIN

PROBLEMATIKA DHE PRIORITETI	TITULLI I AKTIVITETIT	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS
<b>Rritja e besimit të ndërsjellët të Policisë me grupet e interesit dhe qytetarët (për përmirësimin e denoncimit apo dhënien e informacionit) (prioritet i moderuar)</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përmirësimi i komunikimit të çdo institucioni në mënyrë periodike me qytetarët (sipas specifikave të secilit prej institucioneve) kjo mund të arrihet edhe përmes takimeve të caktuara sipas grupit të interesit dhe problematikës</li> <li>2. Reagim i shpejtë dhe transparent ndaj shkeljeve ligjore për të rritur besimin e qytetarëve ndaj institucioneve publike</li> <li>3. Takime periodike të strukturave të komisaritit me kryetarët e fshatrave (për këto takime koordinohet me Bashkinë për të mos krijuar mbingarkesë)</li> <li>4. Në takimet e zhvilluar nga punonjësit e Policisë në komunitet duhet të kihet parasysh kontakti jo vetëm me kryetarin e fshatit por edhe me këshillin e fshatit</li> </ol>	<p>Komisariati i Policisë Kurbin Bashkia Kurbin Prokuroria e Rrethit Gjiqësor Drejtoria Arsimore Grupet e interesit Shkollat</p>
<b>Ndryshimi i imazhit të qytetit ndaj të rinjve (prioritet i moderuar)</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Takime të hapura të komunitetit në shkollë me prezencën e mësuesve, prindërve, nxënësve</li> <li>2. Bashkëpunim midis shkollës dhe OJF-ve që operojnë në Kurbin për të mundësuar aktivitete psiko-sociale për të rinjtë</li> <li>3. Krijimi i fushatave ndërgjegjësuese të iniciuara nga vetë të rinjtë për ndryshimin e imazhit të qytetit të tyre</li> <li>4. Promovimi i rasteve të suksesshme në komunitet nga OJF-të në bashkëpunim me qytetarët</li> <li>5. Emisione televizive nga media lokale dhe kombëtare</li> </ol>	<p>Bashkia Kurbin Drejtoria arsimore Shkollat OJF-të Media</p>

PROBLEMATIKA DHE PRIORITETI	TITULLI I AKTIVITETIT	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS
<b>Kultivimi i bimëve narkotike (prioritet i lartë)</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Hartezimi i zonave me risk të lartë për kultivimin e kanabis dhe një bazë të dhënash të individëve të përfshirë në vite</li> <li>2. Sensibilizimi i komuniteteve në zona me risk të lartë</li> <li>3. Komunikimi publik nga ana e Policisë për territoret në të cilat janë kultivuar bime narkotike</li> <li>4. Përmirësimi i një sistemi vëzhgues të kamerave në qytet në mënyrë të veçantë në zonat e “nxehta”/ hotspote</li> <li>5. Puna operative e Policisë në forma dhe mënyra të ndryshme për të goditur grupet kriminale</li> <li>6. Ndjekja në vazhdimësi të dinamikës së lëvizjes dhe ndryshimit të zonave të “nxehta” për kultivimin e bimëve narkotike</li> </ol>	Bashkia Kurbin Komisariati i Policisë Kurbin

**POLICI**

**BASHKI**

**PROKURORI**

**INTEGRITET**



Institute for Democracy and Mediation  
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



Kingdom of the Netherlands